

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

PËR

DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 64/2012

“PËR PESHKIMIN”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është përditësimi dhe përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit kombëtar të peshkimit me *acquis* të Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit të integritit evropian dhe detyrimeve që burojnë nga Kapitulli 13 “Peshkimi”. Në mënyrë të veçantë, projektligji synon reflektimin në legjislacionin kombëtar të ndryshimeve të sjella nga Rregullorja (BE) 2023/2842 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 22 nëntor 2023, e cila ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1224/2009 për krijimin e sistemit të kontrollit të Bashkimit Evropian për garantimin e pajtueshmërisë me rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit.

Në vitin 2024, nëpërmjet ndryshimeve të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, u realizua përafrimi i pjesshëm i ligjit me një numër rregulloresh të Bashkimit Evropian, konkretisht me Rregulloren e Këshillit nr. 1224/2009/KE, Rregulloren e Këshillit nr. 2371/2002/KE, Rregulloren e Këshillit nr. 1967/2006/KE, Rregulloren e Këshillit nr. 1198/2006/KE, Rregulloren e Këshillit nr. 1005/2008/KE dhe Rregulloren e Këshillit nr. 104/2000/KE. Megjithatë, në vijim të procesit të screening dhe zhvillimeve të reja të *acquis* të Bashkimit Evropian në sektorin e peshkimit, u evidentua nevoja për përditësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor kombëtar, kryesisht në drejtim të monitorimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së aktivitetit të peshkimit.

Ky projektligj synon forcimin e sistemit kombëtar të kontrollit të peshkimit, përmirësimin e gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit, digjitalizimin e proceseve të raportimit dhe monitorimit, si dhe krijimin e bazës ligjore për përdorimin e sistemeve moderne të monitorimit elektronik në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara synohet gjithashtu forcimi i kapaciteteve institucionale të monitorimit të flotës së peshkimit dhe rritja e eficiencës së mekanizmave për luftën kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP).

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje me Programin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) dhe me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integritit evropian për Kapitullin 13 “Peshkimi”. Hartimi i këtij projektligji lidhet drejtpërdrejt me nevojën për rritjen e shkallës së përafrimit të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian në sektorin e peshkimit, si dhe me rekomandimet e evidentuara gjatë procesit të screening bilateral me Komisionin Evropian.

Projektligji është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030, si dhe me Strategjinë Ndërsektoriale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021–2027, e cila synon promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, forcimin e kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit dhe përmirësimin e menaxhimit të resurseve biologjike detare.

Gjithashtu, projektligji kontribuon që vendi ynë si vend kandidat të përmbushë objektivat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit të Bashkimit Evropian, duke synuar garantimin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve biologjike detare, forcimin e kontrollit të aktivitetit të peshkimit dhe rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë në të gjithë zinxhirin e sektorit të peshkimit.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Gjatë procesit të screening bilateral për Kapitullin 13 “Peshkimi”, si dhe gjatë takimeve teknike të zhvilluara me Komisionin Evropian, u evidentua nevoja për përditësimin e kuadrit ligjor shqiptar në fushën e kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit, në përputhje me ndryshimet më të fundit të acquis të Bashkimit Evropian.

Rregullorja (BE) 2023/2842 ka sjellë ndryshime të rëndësishme në sistemin evropian të kontrollit të peshkimit, duke forcuar detyrimet për monitorimin elektronik të flotës së peshkimit, transmetimin elektronik të të dhënave të aktivitetit të peshkimit, përdorimin e sistemeve të monitorimit elektronik në distancë (REM), sistemeve të monitorimit të anijeve (VMS), sistemeve automatike të identifikimit (AIS), si dhe rritjen e gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit.

Në këtë kuadër, projektligji synon të krijojë bazën ligjore për modernizimin e sistemit kombëtar të kontrollit dhe monitorimit të peshkimit dhe për digjitalizimin e proceseve të raportimit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit. Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara krijohet baza ligjore për funksionimin dhe kompetencat e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP), për përdorimin e sistemeve elektronike të monitorimit dhe raportimit, si dhe për transmetimin elektronik të të dhënave mbi aktivitetin e flotës së peshkimit.

Projektligji synon gjithashtu të rrisë eficiencën e monitorimit dhe kontrollit të aktivitetit të peshkimit, duke përmirësuar shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe duke forcuar mekanizmat për luftën kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP). Përmirësimi i sistemit të kontrollit dhe monitorimit do të kontribuojë në rritjen

e besueshmërisë së produkteve shqiptare të peshkimit në tregjet ndërkombëtare, në përmirësimin e gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit dhe në garantimin e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve biologjike detare.

Ndryshimet e propozuara nuk prekin strukturën themelore të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, por synojnë përditësimin dhe modernizimin e tij në përputhje me standardet dhe kërkesat e reja të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit të peshkimit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Projektligji është në përputhje me ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar dhe me instrumentet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit (UNCLOS), instrumentet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO), si dhe detyrimet që burojnë nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit.

Projektligji është në përputhje me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e Politikës së Përbashkët të Peshkimit dhe kontribuon në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integritimit evropian.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji synon përafrimin e pjesshëm të legjislacionit kombëtar me acquis të Bashkimit Evropian, konkretisht me Rregulloren (BE) 2023/2842 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 22 nëntor 2023, e cila ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1224/2009 për krijimin e sistemit të kontrollit të Bashkimit Evropian për garantimin e pajtueshmërisë me rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit.

Gjithashtu, projektligji lidhet me dispozita të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1224/2009, Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1005/2008 për luftën kundër peshkimit IUU dhe Rregullores (BE) nr. 1380/2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit.

Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara rritet shkalla e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit, veçanërisht në drejtim të monitorimit elektronik të flotës së peshkimit, transmetimit elektronik të të dhënave, gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit dhe përdorimit të sistemeve moderne të kontrollit dhe mbikëqyrjes së aktivitetit të peshkimit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është konceptuar në 32 nene dhe synon përditësimin e kuadrit ligjor kombëtar në fushën e peshkimit, në përputhje me ndryshimet e acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht me dispozitat e Rregullores (BE) 2023/2842, e cila ndryshon sistemin evropian të kontrollit të peshkimit të përcaktuar në Rregulloren (KE) nr. 1224/2009.

Neni 1 i projektligjit parashikon disa shtesa dhe ndryshime në nenin 4 të ligjit nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, i cili lidhet me përkufizimet. Nëpërmjet këtij neni synohet përditësimi i terminologjisë ligjore në përputhje me konceptet e reja të legjisllacionit të Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit. Janë riformuluar dhe shtuar një sërë përkufizimesh të reja, si “anije peshkuese”, “autorizim peshkimi”, “fuqia e certifikuar e motorit”, “operacion peshkimi”, “Qendra e Monitorimit të Peshkimit (QMP)”, “Sistemi i Monitorimit të Anijeve (VMS)”, “Sistemi i Monitorimit Elektronik në Distançë (REM)”, “të dhëna të pozicionit të anijes”, si dhe “vëzhgues kontrolli”. Këto përkufizime krijojnë bazën ligjore për modernizimin dhe digjitalizimin e sistemit të kontrollit të peshkimit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2 parashikon shtimin e një dispozite në nenin 16 të ligjit, duke përcaktuar ndalimin e përdorimit të mjeteve goditëse dhe fishekëve gjatë ushtrimit të aktivitetit të peshkimit, me përjashtim të rasteve të përcaktuara shprehimisht në ligj. Gjithashtu, ky nen rregullon përdorimin e pushkëve nënujore në kuadër të peshkimit çlodhës-argëtues. Qëllimi i kësaj dispozite është forcimi i masave për ruajtjen e burimeve biologjike detare dhe kontrollin e metodave të ndaluara të peshkimit.

Neni 3 parashikon shtesa dhe ndryshime në nenin 19 të ligjit, duke zgjeruar kompetencat rregullatore të ministrit përgjegjës për peshkimin. Nëpërmjet këtij ndryshimi parashikohet miratimi me urdhër i masave teknike për konservimin e resurseve detare dhe mbrojtjen e ekosistemeve detare, si dhe miratimi i planeve kombëtare të veprimit në sektorin e peshkimit. Ky ndryshim lidhet drejtpërdrejt me kërkesat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit të Bashkimit Evropian dhe me qasjen e bazuar në ekosistem.

Neni 4 parashikon ndryshime në nenin 30 të ligjit lidhur me lejet e peshkimit tregtar. Nëpërmjet këtij ndryshimi përcaktohet më qartë natyra administrative e lejes së peshkimit dhe procedurat për lëshimin, rinovimin, pezullimin dhe tërheqjen e saj. Gjithashtu, janë shtuar dispozita të reja që lidhen me tërheqjen përfundimtare të lejeve të peshkimit në rastet e masave për rregullimin e kapacitetit të flotës së peshkimit, si dhe krijohet baza ligjore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit. Këto dispozita synojnë forcimin e menaxhimit administrativ të flotës së peshkimit dhe rritjen e kontrollit institucional mbi kapacitetin peshkues.

Neni 5 parashikon shtimin e nenit 34/2 “Peshkimi pa mjete lundruese”. Kjo dispozitë krijon për herë të parë bazën ligjore për regjistrimin dhe monitorimin e aktiviteteve të peshkimit të ushtruara pa mjete lundruese. Nëpërmjet këtij neni synohet formalizimi i këtij segmenti të aktivitetit të peshkimit dhe krijimi i mekanizmave për regjistrimin dhe transmetimin elektronik të të dhënave mbi zëniet. Gjithashtu, ministrisë i ngarkohet detyrimi për krijimin e sistemeve alternative të regjistrimit ose lejimit për personat fizikë dhe juridikë që ushtrojnë këtë aktivitet.

Neni 6 parashikon ndryshime në nenin 52 të ligjit, i cili lidhet me ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme. Ndryshimet kanë për qëllim përmirësimin e procedurave administrative për dhënien e të drejtës së ushtrimit të aktivitetit të peshkimit në këto ujëra, duke përcaktuar më qartë procedurat e konkurrimit, ngritjen dhe përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të tij.

Neni 7 riformulon nenin 67 të ligjit, duke përcaktuar Qendrën e Monitorimit të Peshkimit (QMP) dhe inspektoratin që mbulon fushën e peshkimit si autoritetet përgjegjëse për monitorimin e aktivitetit të peshkimit, sforcos së peshkimit dhe akuakulturës. Ky ndryshim synon qartësimin institucional të kompetencave për monitorimin dhe kontrollin e sektorit.

Neni 8 parashikon shtimin e nenit 67/1 “Qendra e Monitorimit të Peshkimit”. Kjo dispozitë rregullon funksionimin, kompetencat dhe organizimin e QMP-së, duke e përcaktuar atë si strukturën qendrore përgjegjëse për monitorimin e flotës shqiptare të peshkimit dhe të anijeve të huaja të autorizuara për të operuar në ujërat shqiptare. Gjithashtu, ky nen përcakton funksionimin 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë të QMP-së, përdorimin e sistemeve elektronike të monitorimit, si dhe koordinimin me Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD).

Neni 9 riformulon nenin 69 të ligjit që lidhet me autorizimin për peshkim. Nëpërmjet këtij ndryshimi përcaktohen rastet kur anijet peshkuese duhet të pajisen me autorizim peshkimi, veçanërisht kur aktiviteti i tyre lidhet me regjime të sforcos së peshkimit, plane shumëvjeçare menaxhimi, zona të kufizuara peshkimi, peshkimin shkencor ose përdorimin e sistemeve REM. Ky nen synon forcimin e kontrollit administrativ mbi aktivitetet specifike të peshkimit.

Neni 10 riformulon nenin 72 të ligjit dhe krijon bazën ligjore për përdorimin e Sistemit të Monitorimit të Anijeve (VMS). Dispozitat e këtij neni përcaktojnë detyrimin për instalimin e pajisjeve të monitorimit në bord të anijeve të peshkimit, transmetimin automatik të të dhënave mbi pozicionin e anijeve, përdorimin e sistemeve AIS dhe përjashtimet për kategori të caktuara të flotës së vogël të peshkimit. Gjithashtu, ky nen rregullon shkëmbimin e të dhënave me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare të menaxhimit të peshkimit.

Neni 11 parashikon shtimin e nenit 72/1 “Sistemi i monitorimit elektronik në distancë (REM)”. Nëpërmjet kësaj dispozite krijohet baza ligjore për përdorimin e sistemeve REM dhe CCTV në anijet e peshkimit, me qëllim monitorimin dhe kontrollin e respektimit të detyrimit për zbarkim. Gjithashtu, parashikohet mundësia e përdorimit vullnetar të sistemit REM dhe miratimi me urdhër ministri i rregullave të hollësishme teknike për funksionimin e tij.

Neni 12 riformulon nenin 74 të ligjit lidhur me plotësimin e librit të anijes së peshkimit. Nëpërmjet këtij ndryshimi parashikohet mbajtja e librit elektronik të peshkimit nga kapitenët e anijeve peshkuese, si dhe përcaktohen nivelet e tolerancës për sasitë e regjistruara të zënieve. Ky ndryshim synon përmirësimin e gjurmueshmërisë dhe saktësisë së raportimit të aktivitetit të peshkimit.

Neni 13 parashikon shfuqizimin e nenit 75 të ligjit, pasi përmbajtja e tij është bërë e tejkaluar nga dispozitat e reja mbi sistemet elektronike të monitorimit dhe raportimit.

Neni 14 riformulon nenin 77 lidhur me transmetimin elektronik të librit të anijes. Nëpërmjet këtij ndryshimi parashikohen detyrime të qarta për transmetimin elektronik të informacionit të librit të peshkimit në QMP, si dhe rregulla të posaçme për anijet me gjatësi më të vogël se 12 metra.

Neni 15 parashikon shfuqizimin e neneve 78 dhe 79 të ligjit, për shkak të harmonizimit të sistemit të ri elektronik të raportimit dhe monitorimit të aktivitetit të peshkimit.

Neni 16 parashikon ndryshime në nenin 80 të ligjit lidhur me lajmërimin paraprak të hyrjes në port. Nëpërmjet këtij ndryshimi përfshihet edhe Qendra e Monitorimit të Peshkimit si autoritet që duhet të njoftohet paraprakisht nga anijet e peshkimit.

Neni 17 riformulon nenin 82 të ligjit që lidhet me deklaratën e zbarkimit. Ky nen parashikon detyrimin për plotësimin dhe transmetimin elektronik të deklaratës së zbarkimit në QMP, si dhe përcakton kompetencën e ministrit për miratimin e rregullave të hollësishme mbi funksionimin e këtij sistemi.

Neni 18 parashikon zëvendësimin e termit “QNOD” me “QMP” në disa dispozita të ligjit, me qëllim harmonizimin institucional të kompetencave të monitorimit dhe raportimit elektronik të aktivitetit të peshkimit.

Neni 19 riformulon nenin 85 lidhur me transbordimin në det. Nëpërmjet këtij ndryshimi ndalohet transbordimi pa autorizim paraprak dhe parashikohet detyrimi për plotësimin dhe transmetimin elektronik të deklaratës së transbordimit në QMP. Ky ndryshim synon forcimin e kontrollit mbi aktivitetet e transbordimit dhe parandalimin e aktiviteteve të paligjshme të peshkimit.

Neni 20 parashikon shtimin e një dispozite të re në nenin 86 të ligjit, duke përcaktuar detyrimin e ministrisë për regjistrimin dhe administrimin e të dhënave që lidhen me zëniet dhe sforcon e peshkimit. Kjo dispozitë synon përmirësimin e administrimit të të dhënave dhe forcimin e sistemit kombëtar të statistikave dhe monitorimit të peshkimit.

Neni 21 parashikon zëvendësimin në disa dispozita të ligjit të togfjalëshit “anije peshkimi” me togfjalëshin “anije peshkuese”. Ky ndryshim ka karakter teknik dhe terminologjik dhe synon harmonizimin e terminologjisë së përdorur në ligjin kombëtar me terminologjinë e acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht me dispozitat e Rregullores (BE) 2023/2842 dhe Rregullores (KE) nr. 1224/2009. Nëpërmjet këtij ndryshimi synohet qartësimi i dallimit ndërmjet konceptit të përgjithshëm të “anijes së peshkimit” dhe “anijes peshkuese” si mjet i përdorur drejtpërdrejt për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit.

Neni 22 parashikon shtimin e një dispozite të re në nenin 93 të ligjit, e cila lidhet me grumbullimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës. Nëpërmjet kësaj dispozite krijohet baza ligjore për miratimin me udhëzim ministri të rregullave dhe formatit të dërgimit të planeve të punës dhe raporteve vjetore mbi grumbullimin e të dhënave për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës. Ky ndryshim synon forcimin e sistemit kombëtar të mbledhjes dhe administrimit të të dhënave statistikore dhe shkencore në sektor, në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian dhe organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit.

Neni 23 parashikon shtimin e një dispozite të re në nenin 102 të ligjit, e cila krijon një mekanizëm kalimtar për rregullimin e rasteve të mospërputhjes së fuqisë motorike të anijeve peshkuese me fuqinë e autorizuar të përcaktuar në lejen e peshkimit. Nëpërmjet këtij ndryshimi parashikohet që anijet peshkuese të cilat deri më datën 31.12.2025 rezultojnë me fuqi motorike më të lartë se ajo e autorizuar, të kenë mundësinë të korrigjojnë këtë situatë brenda një periudhe njëvjeçare nga hyrja në fuqi e ligjit. Korrigjimi bazohet në të dhënat e regjistrave të Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe në pagesën e diferencës së taksës vjetore për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit. Kjo dispozitë synon formalizimin e situatave ekzistuese dhe përmirësimin e administrimit të kapacitetit të flotës së peshkimit.

Neni 24 riformulon pikën 4 të nenit 113 të ligjit, e cila lidhet me procedurat e peshimit të produkteve të peshkimit. Nëpërmjet këtij ndryshimi përcaktohen subjektet që mund të kryejnë aktivitetin e peshimit, si blerësit e regjistruar, ankandet, organizatat e prodhuesve ose persona të tjerë fizikë apo juridikë të njohur nga ministria. Gjithashtu, operatorëve që kryejnë peshimin u ngarkohet përgjegjësia për saktësinë e peshimit dhe detyrimi për mbajtjen e regjistrave të peshimit për një periudhë trevjeçare. Ky ndryshim synon forcimin e gjurmueshmërisë dhe kontrollit të produkteve të peshkimit përgjatë procesit të zbarkimit dhe tregimit.

Neni 25 riformulon nenin 117 të ligjit lidhur me shkeljet e rënda në sektorin e peshkimit. Nëpërmjet këtij ndryshimi përcaktohet në mënyrë më e detajuar lista e shkeljeve që konsiderohen të rënda, në përputhje me kërkesat e acquis të Bashkimit Evropian dhe rregullat ndërkombëtare të kontrollit të peshkimit. Ndër shkeljet e parashikuara përfshihen ushtrimi i aktivitetit pa leje ose autorizim të vlefshëm, falsifikimi i dokumenteve dhe identitetit të anijes, pengimi i punës së inspektorëve dhe vëzhguesve, transbordimi i paligjshëm, bashkëpunimi me anije të listuara si PPP, përdorimi i pajisjeve të ndaluara të peshkimit, manipulimi i motorëve dhe përdorimi i punës së detyruar. Ky nen synon forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe të luftës kundër peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar (PPP), si dhe harmonizimin e sistemit kombëtar të kundërvajtjeve me standardet e Bashkimit Evropian.

Neni 26 parashikon shtimin e një dispozite të re në nenin 118 të ligjit, duke përcaktuar se rregullat e detajuara për zbatimin e vendimeve administrative të parashikuara në këtë nen miratohen me udhëzim ministri. Ky ndryshim synon krijimin e bazës ligjore për rregullimin më të detajuar procedural të masave administrative në sektorin e peshkimit.

Neni 27 riformulon pikën 4 të nenit 125 të ligjit, e cila lidhet me monitoruesit e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës. Nëpërmjet këtij ndryshimi përcaktohet se monitoruesit janë pjesë e strukturave të ministrisë ose të institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës dhe mbledhin të dhëna, statistika dhe informacion sipas kërkesave të strukturave përgjegjëse kombëtare dhe organizatave ndërkombëtare përkatëse, përfshirë Komisionin Evropian dhe Komisionin e Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun (GFCM). Ky ndryshim synon forcimin e sistemit të monitorimit shkencor dhe statistik të sektorit të peshkimit.

Neni 28 parashikon ndryshime në nenin 130 të ligjit lidhur me sistemin e pikëve për shkeljet e rënda. Nëpërmjet këtij ndryshimi riformulohet sistemi i pezullimit dhe tërheqjes së lejeve të peshkimit dhe të drejtës për të komanduar një anije peshkimi si kapiten, në rastet e akumulimit të pikëve për shkelje të rënda. Dispozita përcakton periudha progresive pezullimi dhe, në rast të

përsëritjes së shkeljeve dhe tejkalimit të pragut maksimal të pikëve, tërheqjen përfundimtare të lejes së peshkimit. Ky ndryshim synon forcimin e efektit parandalues dhe ndëshkues të sistemit të kontrollit të peshkimit, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Neni 29 parashikon shtimin e një dispozite të re në nenin 132 të ligjit lidhur me shpërblimin e anëtarëve të komisioneve. Nëpërmjet këtij ndryshimi përcaktohet se masa e shpërblimit të anëtarëve të komisioneve do të jetë sipas legjislacionit në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të këshillave, bordeve dhe komisioneve të përhershme. Ky ndryshim synon unifikimin e praktikës administrative dhe qartësimin e bazës ligjore për trajtimin financiar të komisioneve.

Neni 30 parashikon ndryshime në nenin 128 të ligjit lidhur me kundërvajtjet administrative dhe masat ndëshkuese. Nëpërmjet këtij ndryshimi parashikohen masa administrative për mosinstalimin, dëmtimin, manipulimin ose nxjerrjen jashtë funksionit të sistemeve REM, si dhe për mosrespektimin e detyrimeve që lidhen me transbordimin dhe deklaratat përkatëse. Ky ndryshim synon forcimin e zbatimit të sistemeve elektronike të monitorimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë së operatorëve të sektorit të peshkimit në raport me detyrimet e reja ligjore.

Neni 31 përmban dispozitat kalimtare të projektligjit dhe përcakton afatet për instalimin e Sistemit të Monitorimit të Anijeve (VMS) dhe Sistemit të Monitorimit Elektronik në Distançë (REM) në flotën shqiptare të peshkimit. Nëpërmjet kësaj dispozite parashikohet një zbatim gradual i detyrimeve të reja teknike, duke marrë në konsideratë kapacitetet administrative dhe financiare të sektorit. Ky ndryshim synon garantimin e një periudhe të arsyeshme tranzitore për përshtatjen e operatorëve me kërkesat e reja ligjore dhe teknike.

Neni 32 parashikon shtimin e një dispozite të re në nenin 135 të ligjit lidhur me aktet nënligjore. Nëpërmjet këtij ndryshimi ngarkohet ministri përgjegjës për peshkimin për miratimin, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e dispozitave të reja të projektligjit. Kjo dispozitë synon garantimin e zbatimit efektiv dhe funksional të ndryshimeve të propozuara në ligj, nëpërmjet plotësimit të kuadrit nënligjor përkatës.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është përgatitur nga grupi i punës ngritur me Urdhrin Nr. 320, datë 26.3.2026, të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk krijon efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit lidhur me krijimin dhe funksionimin e Qendrës së Monitorimit të Peshkimit (QMP), pasi strukturat dhe funksionet përkatëse do të sigurohen brenda numrit aktual të miratuar të punonjësve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucioneve të saj të varësisë, konkretisht nëpërmjet riorganizimit të institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës (DSHPA).

Gjithashtu, në Ligjin nr. 64/2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, është parashikuar ngritja e Komisionit të Përherëshëm të Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit, Komisionit të Vlerësimit të Kërkesave dhe Komisionit për Shqyrtimin e Ankimimeve. Në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2012, ‘Për peshkimin’, të ndryshuar” është përcaktuar se masa e shpërblimit të anëtarëve të këtyre komisioneve do të jetë sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të këshillave, bordeve dhe komisioneve të përherëshme.

Komisioni i Përherëshëm i Shqyrtimit të Lejeve të Peshkimit, i përbërë nga 5 persona (1 kryetar dhe 4 anëtarë), si organ që trajton dokumentacionin e paraqitur nga subjektet e peshkimit për pajisjen me leje peshkimi tregtar, mbledhet një herë në javë me qëllim shqyrtimin e praktikave brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin kombëtar për lejet dhe licencat. Pavarësisht kësaj, nuk parashikohen më shumë se 12 pagesa në vit, në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë për çdo anëtar.

Komisioni i Vlerësimit të Kërkesave, i përbërë nga 5 persona (1 kryetar dhe 4 anëtarë), është organi që zhvillon procedurat e konkurrimit publik për fitimin e së drejtës së peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det pa përdorimin e mjeteve lundruese, si dhe zhvillimin e akuakulturës në sipërfaqe publike tokësore dhe ujore. Ky komision vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga subjektet gjatë procedurave të konkurrimit publik dhe mbledhet rast pas rasti. Për anëtarët e tij parashikohen jo më shumë se 12 pagesa në vit, në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë për çdo anëtar.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankimimeve, i përbërë nga 5 persona (1 kryetar dhe 4 anëtarë), si organ që trajton ankesat e paraqitura nga subjektet e peshkimit dhe akuakulturës, mbledhet rast pas rasti dhe për anëtarët e tij parashikohen jo më shumë se 12 pagesa në vit, në masën 10.000 (dhjetë mijë) lekë për çdo anëtar.

Me hyrjen në fuqi të projektligjit në fjalë, do të vijojë procedura për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përherëshme të njësive të qeverisjes qendrore”, duke përfshirë edhe komisionet e sipërpërmendura.